

GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i
Gjykatës Themelore të Prizrenit
Janar – Mars 2015

Buletin informativ “Gjykatë e Hapur”
Nr. 3, Prill 2015
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.kgjk-ks.org

PËRMBAJTJE:

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Vazhdon hapja e Gjykatës

STORIE E SUKSESIT

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Programin e Praktikantëve

LAJME

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA

Trasmetimi i spotit televiziv “Gjykatë e hapur” në RTK 3

INTERVISTË E SHKURTË

Gjykata Themelore në Prizren me epitelin “gjykata model” në nivel vendi (Teuta Krusha)

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Kërkesa për pjesëmarrje në seancë
A e dini se...?!

KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT



Vazhdon hapja e Gjykatës

Të nderuar lexues,

Gjykata Themelore e Prizrenit është gjykatë e hapur, e cila po bën përpjekje që t'i përfshijë në punën e saj të gjithë qytetarët e Prizrenit. Si institucion gjyqësor kemi krijuar një traditë të mirë të bashkëpunimit me shumë partnerë, të cilën tashmë e kemi zgjeruar me institucionet arsimore dhe organizatat aktive të shoqërisë civile, me përqendrim në transparencën e punës së Gjykatës.

Kësisoj në fillim të muajit prill si Gjykatë Themelore kemi nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit për Programin e Praktikantëve për Marrëdhëniet Publike me Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe OJQ-në "EC Ma Ndryshe".

Ky program i praktikantëve është krijuar për t'i ofruar mbështetje Zyrës për Informim Publik të Gjykatës Themelore të Prizrenit, me qëllim të forcimit të angazhimit të saj për ngritjen e transparencës dhe komunikimit efektiv të Gjykatës me qytetarët.

Programi i praktikantëve është i hapur për studentët e Universitetit të Prizrenit, të të gjitha drejtimeve, të cilët janë të interesuar për të marrë njohuri dhe përvoja të reja dhe për kontribuuar në punën e Gjykatës Themelore të Prizrenit.

Përfitues nga ky bashkëpunim i ri do të jenë studentët dhe punonjësit e Gjykatës, por edhe qytetarët në përgjithësi ngase gradualisht do të forcohet komponenti i marrëdhënies publike, që deri vonë nuk ka qenë prezent në punën e gjyqësorit.

Në saje të kësaj nisme të re, sikurse edhe veprimeve të mëparshme, Gjykata Themelore e Prizrenit po e dëshmon përkushtimin e saj për transparencë, që është e domosdoshme për rritjen e besimit të qytetarëve në organet e gjyqësorit, por edhe të sistemit të drejtësisë në përgjithësi.

Gjykata Themelore e Prizrenit mbetet e përkushtuar për të jetësuar praktikën e mira që mundësojnë efikasitet, paanshmëri, llogaridhënie dhe transparencë në punën e saj. Gjithashtu përmes avansimit të marrëdhënieve me publikun dëshiron që të sigurojë qytetarët se ajo është garantuese e vërtetë e zbatimit të të drejtave të njeriut.

Ymer Hoxha

Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Programin e Praktikantëve në GjThP

Gjykata Themelore e Prizrenit – Zyra për Informim Publik, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe organizata EC Ma Ndryshe kanë nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit për Programin e Praktikantëve për Marrëdhëniet Publike. Programi i praktikantëve u krijua për t'i ofruar ndihmë Zyrës për Informim Publik të Gjykatës Themelore të Prizrenit me qëllim të forcimit të angazhimit për ngritjen e transparencës dhe komunikimit efektiv të gjykatës me qytetarët. Programi i praktikantëve do të jetë i hapur për studentët e Universitetit të Prizrenit (të gjitha drejtimet) të interesuar për të marrë njohuri dhe përvoja të reja dhe kontribuuar në punën e Gjykatës Themelore të Prizrenit. Praktikantët do të angazhohen në cikle tre-mujore (me mundësi vazhdimi) përmes thirrjeve të rregullta publike. Kjo iniciativë është një hap tjetër me qëllim të forcimit të angazhimit për ngritjen e transparencës dhe komunikimit efektiv të gjykatës me qytetarët.



LAJME

Gjykata Themelore priti për vizitë Fondacionin Atmosfera nga Prizreni

Interesimin për të vizituar Gjykatën Themelore në Prizren po e shprehin çdo ditë e më shumë edhe nxënësit dhe studentët e qytetit të Prizrenit. Një grup nxënësish të shkollave të mesme të Prizrenit të udhëhequr nga Fondacioni Atmosfera, ishin vizitorët e radhës të kësaj gjykate.

Nxënësit u pritën nga Kryetari i gjykatës z.Hoxha dhe Zyrtarja për Informim znj.Kicaç. Përveç sesionit të diskutimit, nxënësit vizituan edhe objektin e gjykatës, për t'u njohur më mirë me departamentet, zyrat administrative dhe sallat e gjyqimit.



Kryetari i GjThP priti në takim pune Komandantin e Policisë Rajonale të Prizrenit dhe u.d. Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore të Prizrenit

Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit ka pritur në një takim pune Komandantin e Policisë Rajonale të Prizrenit, Nexhmi Krasniqin dhe u.d. Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore të Prizrenit, Metush Biraj dhe bashkëpunëtorët e tij.

Në këtë takim pune u bisedua rreth bashkëpunimit të mirë institucional, por në veçanti u bisedua edhe për sfidat me të cilat ballafaqohen të trija institucionet gjatë punës së tyre të përditshme.

Rëndësi të veçantë në këtë takim i'u dha zbatimit të Urdhër- arresteve si dhe Letër- rreshtimeve të lëshuara nga gjykata, me qëllim të ekzekutimit të Aktgjykimeve të plotfuqishme. Përveç kësaj si sfida tjetër është edhe mungesa e prokurorëve nëpër seanca, e të cilat po ndikojnë shumë në punën e gjykatës.

Z. Hoxha falënderoj pjesëmarrësit e këtij takimi dhe potencoi se takimet e këtij lloji janë të dobishme dhe ndikojnë në rritjen e efikasitetit, nivelit të përgjegjësisë, dhe duhet të mbahen më shpesh.

Ambasadorja e SHBA-së Trejsi Xhejkobson e vizitoi Gjykatën Themelore të Prizrenit

Me 20.02.2015, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan Ambasadorja e SHBA-së Trejsi Xhejkobson; David Greer, Drejtor i Programit për Përmbarrim dhe Legjislacion Komercial (CLE) i USAID-it dhe Xhim Hop, Drejtor i misionit.

Në këtë takim u bisedua për ndërmjetësimin dhe reduktimin e lëndëve përmbarrimore duke u bazuar në tre komponentët kryesore të aktivitetit:

1. Përmbarrimi i aktgjykimeve (eliminimi i lëndëve përmbarruese në gjykata, përkrahja për M e D të zbatojë sistemin e përmbarruesve privat)
2. Legjislacioni komercial (Ndërmjetësimi, Regjimi dhe Ligji i ri për Falimentim)
3. Edukimi i publikut dhe komunikimi me publikun-praktikat transaksionale biznesore, trajnimi juridik dhe për avokim në temat e legjislacionit komercial.



Kryetari i gjykatës z. Ymer Hoxha, vizitën e Ambasadores Xhejkobson e vlerësoj si përkrahje dhe mbështetje për punë të mëtutjeshme. Z.Hoxha e falënderoj Ambasadoren dhe bashkëpunëtorët për investimet që bënë USAID-i në të gjitha segmentet e jetës në shoqëri e në veçanti për gjyqësorin.

Z.Hoxha e siguroj Ambasadoren që gjykata është e përkushtuar në luftimin e të gjitha formave të krimit në atë mënyrë që të krijojë një ambient të qetë për qytetarët. Kryetari ndër të tjera foli për rezultatet dhe për sfidat e kësaj gjykate. Ambasadorja e përkrahu punën e mirë të Gjykatës dhe premtoj që edhe në të ardhmen qeveria e saj do ta mbështes Kosovën.

Forumi i gjyqtareve dhe prokuroreve në takim me praktikantët e Gjykatës dhe Prokurorisë Themelore në Prizren.



Muaji shkurt u kurorëzua me një takim shumë të veçantë në mes të Forumit të gjyqtareve dhe prokuroreve me praktikantët e Gjykatës dhe Prokurorisë Themelore në Prizren, në lidhje me rolin dhe pozitën e Forumit të gjyqtareve dhe prokuroreve në Sistemin Gjyqësor të Kosovës.

Qëllimi i këtij takimi ishte që të fuqizohet prania e grave në sistemin e drejtësisë, e në veçanti e gjyqtareve dhe prokuroreve me një zë unik dhe vision për të promovuar barazi dhe respekt për të gjithë.

Forumi do të krijojë një ambient ku gratë do të kenë mundësi dhe mbështetje për ndryshim përmes pjesëmarrjes aktive, për një sistem ligjor ku të gjithë njerëzit do të trajtohen me dinjitet dhe barazi. Puna e forumit do të mundësoj përmirësimin e pozitës së gjyqtareve dhe prokuroreve aktuale dhe gjeneratave të ardhshme.

Në këtë takim morën pjesë:

- Gjyqtarja e Departamenti të Përgjithshëm/Civil, Shpresa Emra si koordinatore për regjionin e Prizrenit.
- Prokurorja e Prokurorisë Themelore të Prizrenit, Ervehe Gashi si zv.koordinatore e regjionit të Prizrenit.
- Gjyqtarja e Departamentit të Përgjithshëm/Civil, Edija Sezairi
- Zëdhënësja e Gjykatës Themelore të Prizrenit, Afrëdita Kicaj

Tryezë e rrumbullakët e GjThP me gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë



Në muajin mars, Gjykata Themelore në Prizren, e mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, mbajti një tryezë të rrumbullakët me gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë nga rajoni i Prizrenit. Ky takim është takimi i parë në vargun e tri tryezave të rrumbullakëta, që kanë për qëllim rritjen e pajtueshmërisë së Gjykatës Themelore me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Në takim morën pjesë 35 gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë. Gjatë diskutimit u theksua që të pranishmit kanë njohuri rreth Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe rolin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ndonëse rrallëherë e aplikojnë apo i referohen të njëjtës gjatë procedurave, në parashtrësia, vendime dhe aktgjykime, për shkak të faktorëve që u identifikuan gjatë tryezës së rrumbullakët: mungesa e literaturës në gjuhët zyrtare, koha e pamjaftueshme, numri i madh i lëndëve. Me qëllim të aftësimit të pjesëmarrësve për të përdorur më mirë bazën e të dhënave të GJEDNJ-së (HUDOC), aktiviteti përfshiu edhe një prezantim praktik mbi mënyrën e të kërkuarit të aktgjykimeve në gjuhët lokale.

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela më poshtë paraqet statistikën e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit për tre muajin e parë të vitit 2015, si ato të trashëguara nga 2014, të ardhura, lëndët në proces, lëndët që janë përfunduar në këtë tre muaj dhe ato të mbetura në fund të tremujorit 2015. Statistikat e punës për tremujorin e parë të vitit 2015 janë dëshmia e radhës numerike e përkushtimit maksimal të Gjykatës për t'i shërbyer qytetarëve.

Gjykata Themelore në Prizren	Lëndët e trashëguara në fillim të 2015	Lëndët e ardhura gjatë TRE muajorit - I	Gjithsej lëndët në punë gjatë TRE muajorit - I	Lëndët e kryera gjatë TRE muajorit - I	Lëndët e mbetura në fund të TRE muajorit - I
Departamenti për Krime të Rënda	423	117	540	111	429
Departamenti i Përgjithshëm	19451	5576	25027	4796	20231
Departamenti për të mitur	241	79	320	51	269
Divizioni i Kundërvajtjes	4840	6458	11298	4922	6376
Totali	24955	12230	37185	9880	27305

*Në këto statistika nuk përfshihen degët e gjykatës në Suharekë dhe Dragash

Transmetimi i spotit televiziv “Gjykatë e hapur” në RTK 3

GjThPz përmes angazhimit të Zyrës për Informim dhe KGJK-së kanë bërë të mundur që spoti i shkurtë televiziv “Gjykatë e Hapur” të transmetohet në RTK 3.

Transmetimi i këtij spoti në televizionin publik ka pas për qëllim informimin e qytetarëve për gjykatën e tyre, degët dhe departamentet e gjykatës, rioorganizimin e zyrave administrative dhe mbështetëse të gjykatës, mënyrën e dorëzimit të shkresave në gjykatë, seancat gjyqësore dhe “Ditën e hapur”.

Spoti televiziv “Gjykatë e hapur” është realizuar në kuadër të projektit “Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë”, mbështetur nga USAID dhe Atrc dhe zbatuar nga OJQ EC Ma Ndryshe në bashkëpunim me GjThP-në.



INTERVISTË E SHKURTË

Gjykata Themelore në Prizren me epitelin “gjykata model” në nivel vendi



TEUTA KRUSHA

Greva e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë muajit mars, ka bërë që një numër i madh gjykimesh të mos mbahen, megjithatë lëndët në fjalë nuk janë lënë në harresë por ato janë caktuar sërish nga ana e gjyqtarëve sipas orarit të gjykimeve dhe planit të punës së gjyqtarit. Në një

afat të arsyeshëm lëndët në fjalë do të trajtohen në pajtim me dispozitat ligjore ku palët në procedurë nuk do të humbin në kohë, e për këtë angazhohet edhe Teuta Krusha, gjyqtare në Departamentin e Përgjithshëm, lëminë penale, pranë GjThP, të cilën e intervistuar për këtë numër të buletinit.

1. Pse nuk ka punuar Gjykata Themelore në Prizren gjatë muajit mars?

Gjithë gjyqtarët e Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës, që nga data 03.03.2015 kanë qenë në grevë, me qëllim të realizimit të kërkesës për rritjen e pagave për 25 % në mënyrë retroaktive nga data 01.04.2014 dhe zbatimin e vendimit të ministrit të drejtësisë, për shtesa në paga në shumën prej 200 €. Pjesë e kësaj greve ishin edhe gjyqtarët e kësaj gjykate dhe kjo është arsyeja për ndërprerjen e punës. Mirëpo duke u bazuar në kompetencën tonë dhe obligimeve ligjore që kemi, ju theksoj se gjatë kësaj periudhe sa ka zgjatur greva ne i kemi trajtuar rastet e ndjeshme, ashtu që janë mbajtur gjykimet në çështjet të natyrës urgjente, janë trajtuar lëndët me paraburgim, dhuna në familje dhe rastet tjera që sipas strategjisë së punës së gjykatave llogariten si emergjente. Ju theksoj se gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prizren, në situatën çfarë jemi tani, presim që nga kompetentët të ndërmarrin veprime ligjore, me qëllim të tejkalimit të kësaj situatë të pakëndshme dhe krijimin e kushteve që sa më parë të kthehemi detryrave tona.

2. Greva e gjyqtarëve sa ka ndikuar në të drejtën e qytetarëve për të pas gjykim të shpejtë?

Gjatë kësaj kohe numër i madh i gjykimeve nuk është mbajtur, që është në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Evropiane për Lirit dhe Drejtat e Njeriut, ku në paragrafin 1. të këtij neni ndër tjera thuhet “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet brenda një afati të arsyeshëm”. Mirëpo nëse merret parasysh puna shumë vjeçare e gjyqtarëve në këtë gjykatë dhe rezultatet e punës të cilat janë evidente, me kryerjen e numrit të madh të lëndëve për një kohë të arsyeshëm, atëherë kjo periudhë kohore në të cilën po aludoni nuk mund të ndikoj në të drejtën e qytetarëve për gjykim të

shpejtë. Gjykimet të cilët nuk janë mbajtur gjatë kësaj periudhe kohore, pra lëndët në fjalë nuk janë lënë në hareshë por përkundrazi ato janë caktuar sërish nga ana e gjyqtarëve dhe atë sipas orarit të gjykimeve dhe planit të punës së gjyqtarit. Pra në një afat të arsyeshme lëndët në fjalë do të trajtohen në pajtim me dispozitat ligjore ku palët në procedurë nuk do të humbin në kohë.

3. Shtyrja e qindra seancave për shkaqe të grevës si ndikon në imazhin e vet GjThP?

Mendoj se imazhi i Gjykatës Themelore në Prizren është në nivel. Duke u bazuar në rezultatet e punës dhe kualitetin e lëndëve të trajtuara nga ana e gjyqtarëve, është arsyetuar dhe vërtetuar nga raporti zyrtar i kësaj gjykate, me ç'rast kemi marrë epitetin "gjykata model" në nivel vendi. E gjithë kjo është rezultat i punës dhe pasjes serioze në punë nga ana e gjyqtarëve të cilët edhe kanë ndikuar në arritjen e rezultatit pozitiv. Ky imazh i krijuar ndër vite nuk mund të njolloset për një kohë të shkurtër, sepse po punohet në drejtim të asaj që sa më shpejt të kthehemi punës.

4. Sipas jush, si mund të avancohet besimi i qytetarëve në punën e gjyqësorit?

Me punë profesionale dhe me organizim të mirë (formimi i planit të punës në pajtim me planin strategjik), është rruga kryesore drejtë rezultatit në punë, e cila ndikon në

avancimin e besimit të qytetarëve në punën e gjykatës. Sa për ilustrim, udhëheqësi i këtij institucioni në bazë të një organizimi sipas planit të lartpërmendur dhe fal punës së gjyqtarëve ka arritur sukses në këtë drejtim. Theksoj se lëndët janë trajtuar sipas këtij plani ku shihet qartë edhe nga të dhënat zyrtare mbi rezultatet e punës shumë vjeçare të kësaj gjykate, del se për një kohë relativisht të shkurtër janë kryer shumë lëndë, ku qytetarët kanë realizuar kërkesat e tyre, ky është faktori kryesor për fitimin e besimit të qytetarëve. Prandaj duke u bazuar në rezultatet zyrtare dhe raportin e punës të kësaj gjykate, unë jam shumë e bindur se qytetarët tanë kanë besimin në punën e gjyqësorit. Edhe pse për momentin është ndalur puna në gjykatë, me përgjegjësi të plotë theksoj se duke u bazuar në punën dhe sukseset të cilat kanë arritur gjyqtarët e kësaj gjykate do të kthehen punës së tyre dhe do të japin maksimumin për kompensimin e kohës së humbur. E si rezultat i përkushtimit tonë, besimi i qytetarëve nuk do të mungoj.

5. Puna e gjyqtarëve a është ndihmesë në këtë drejtim?

Në çdo moment puna e pa anshme dhe objektive e gjyqtarëve është bazë për krijimin e besimit të qytetarëve në gjyqësor, sepse me punë kualitative arrihet forcimi i bindjes së shoqërisë tek institucionet e drejtësisë.

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Kërkesa për pjesëmarrje në seancë

Si rregull e përgjithshme, seancat janë të hapura për publikun përveç nëse mbahen *in camera*¹ sipas ligjit. Mirëpo, sallat e gjykimit janë me hapësirë të kufizuar. Gjykata duhet të mbajë nën kontroll pjesëmarrjen e personave dhe të lehtësojë qasjen për qytetarët e interesuar për prani në seanca, posaçërisht për lëndët të cilat tërheqin interesim të madh. Prandaj, të gjitha kërkesat për pjesëmarrje në seanca duhet të procedohen nëpërmjet Koordinatorit për informim publik.

A e dini se...?!

1. Çdo person ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij të ligjshme. Çdo person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër një vendimi gjyqësor apo administrativ që cenon të drejtën apo interesat e tij në mënyrën e caktuar me ligj. (LIGJI Nr. 03/L-199 PËR GJYKATAT, Neni 7, paragrafi 3)

2. Të gjitha seancat gjyqësore do të jenë të hapura për publikun përpos nëse ligji e përcakton ndryshe. (LIGJI Nr. 03/L-199 PËR GJYKATAT, Neni 7, paragrafi 4)

Rregullë: Gjykata aplikon parimin "i pari që vjen i pari shërbehet" gjatë shqyrtimit të kërkesave për pjesëmarrje në seanca në rastet kur salla e gjykimit nuk mund të pranojë të gjithë të interesuarit. Kjo nuk aplikohet ndaj paraqitësve të kërkesës të cilët kanë lidhje familjare me ndonjë palë, ngase ata kanë prioritet.

¹ in camera- në kamera (private), nënkupton rastet gjyqësore ku publiku dhe shtypi nuk janë të lejuara për të marrë pjesë.



KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT

ZYRA E ADMINISTRATËS:

Tel: +381 (0) 29 / 244 122

ADRESA:

Gjykata Themelore e Prizrenit
Rr. "Ibrahim Lutfiu ", p.n.
Prizren, Kosovë

VIZITO:

www.kgjk-ks.org



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

OSNOVNI SUD U PRIZRENU –PRIZREN TEMEL MAHKEMESI
BASIC COURT OF PRIZREN



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

Ky publikim është rezultat i bashkëpunimit mes Gjykatës Themelore të Prizrenit dhe EC Ma Ndryshe, në kuadër të iniciativës "Gjykatë e Hapur".